



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.10.2022, të parashtruar nga Operatori " VB.TOFAJ " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac " , Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521., nxjerr:

### V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit " VB.TOFAJ " SH.P.K., e dt.17.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac " , Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521., kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 11.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 11.10.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.17.10.2022, Operatori Ekonomik " VB.TOFAJ " SH.P.K.,,ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac " , Nr. i prokurimit- 632-22-8235-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-086-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Sa i përket pretendimit tuaj të parë për deklaratën e lëshuar nga banka, të prezantuar nga Grupi i Operatorëve ekonomik "REA" sh.p.k, & "V – SHALA" sh.p.k., mendojmë se nuk qëndron sepse banka nuk e ka refuzuar por i ka lëshuar deklaratën për mbështetje financiare ;

Për pretendimin tuaj të dytë se referencat e prezantuara nga Grupi i Operatorëve ekonomik "REA" sh.p.k, & "V – SHALA" sh.p.k.nuk i plotësojnë kriteret ashtu siç është kërkuar në FDT, sepse të gjitha referencat e prezantuara nga lideri janë për ndërtimin e rrugëve, Autoriteti kontraktues sqaron se këtë e ka konsideruar si devijim të vogël, sepse edhe ndërtimi i shtratit të lumenjve, pendave dhe kanaleve hyjnë te ndërtimet e ulëta sikurse ndërtimi -asfaltimi i rrugëve.

Pertendimet tuaja lidhur me Operatorët tjerë ekonomik: Lulëzim Beqiraj B.I., Infra Plus sh.p.k dhe Roza Komani B.I., nuk do t'i shqyrtojmë sepse të njëjtët janë të eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës